



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritime Evropiane

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 03.10.2017, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Fitore Pacolli, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

Munguan: Driton Çausi, Fikrim Damka, Zenun Pajaziti dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu Kodra – kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Konstituimi i Komisionit për Integritime Evropiane

Kryetarja, Blerta Deliu- Kodra, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e parë konstituive të komisionit.

Fillimisht iu uroi mirëseardhje dhe sukses anëtarëve të komisionit, në punën e përbashkët të komisionit.

Në vazhdim, kryetarja theksoi se me vendim të seancës, tani është caktuar përbërja e komisioneve, partitë politike i kanë dërguar përfaqësuesit e vet dhe seanca sot ka votuar përbërjen e komisioneve, duke përfshirë edhe Komisionin për Integritime Evropiane.

Siç e dimë, Komisioni për Integritime Evropiane është komision kryesor i Kuvendit të Kosovës, po ashtu është komision kryesor, sa i përket procesit të integritimit evropian.

Kemi një rrugë të gjatë dhe me plot sfida, para nesh, të cilën besoj se me një bashkëpunim të mirë, do ta kalojmë së bashku.

Në mbledhjet e radhës do të përgatisim planin e punës së komisionit, ku do ta diskutojmë secilin detaj dhe objektiv se çka do të parashohim në plan të organizimit të punës, si komision dhe së bashku do ta miratojmë.

Plani i punës do të bazohet kryesisht në mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit, në përmbushjen e obligimeve, të cilat dalin nga dokumentet kyçe të procesit të integritetit, siç është MSA, do të ftohen ministra për të raportuar për Programin për zbatimin e MSA-së, si dhe në agjendën për reforma evropiane.

Në vazhdim, hapi diskutimin.

Pasi nuk kishte diskutues të paraqitur, kryetarja i ftoi anëtarët që të votojnë.

Kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, votoi konstituimin e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:25.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Znj. Blerta Deliu-Kodra